

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
--	---	---

Për: Bajram Thaqi , Prishtina e Re-Zona Perendim

Nga : Drejtoria e Urbanizmit, Komuna e Prishtinës

Subjekti: Përgjigje për banorin e lagjes, Bajram Thaqi

Data: 28.05.2025

Banori i lagjes ‘Prishtina e Re-Zona Perendim’, Bajram Thaqi, pronar i parcelave kadastrale me nr. 421-3, 422-8, 422-9 dhe 423-8, ZK. Çagllavice, Prishtinë, të shtrira në kuadër të Planit Rregullues Urban - Prishtina e Re - Zona Perëndim, Blloku H-5 dhe H-7, na ka njoftuar se ka patur disa takime me kompaninë “SHALA GROUP” SH.P.K. me seli në Prishtinë për të arritur një marrëveshje për ndërtimin e përbashkët dhe zhvillimin e projektit në blloqet e lartpërmendura, mirëpo oferta është refuzuar nga kompania. Kërkesa e këtij banori është që në asnjë rast, të mos vazhdohet me procedura për t’i pajisur me kushte dhe leje ndërtimore parcelat nr. 421-3, 422-8, 422-9 dhe 423-8, ZK. Çagllavice, dhe ato fqinjë që tangjentojnë me parcelat e lartpërmendura, pa pëlqimin tij.

Lidhur me kërkesën e parashtruar ju informojmë se Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në bazë të rregullativës, i zbaton Planin Rregullues në fuqi. Në këtë rast do të veprojmë në bazë të kriterëve të Planit Rregullues ‘Prishtina e Re-Zona Perendim’ në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës 01 Nr. 35-186850 dt. 02.10.2013, të cilin plan mund ta gjeni në web-faqen e Komunës së Prishtinës në linkun,

<https://prishtinaonline.com/drejtorite/planifikim-strategjik/sektori-i-planifikimit-hapesinor/plani-rregullues-urban-prishtina-e-re-zona-perendim>

https://prishtinaonline.com/uploads/pr_prishtina_e_re_zona_perendim_pjesa_tekstuale.pdf

https://prishtinaonline.com/uploads/c3_kushtet_e_ndertimit_-_tipologjita_e_ndertimit_2017-04-25_15-13-13.pdf

Sa i përket blloku H5 dhe H7 që ju i referoheni, ju informojmë se Drejtoria e Urbanizmit ka lëshuar “Kushtet Ndërtimore 05 NR. 350/02-26210/23 dhe 05 NR. 350/02-236549/23 DT. 22.04.2024, për parcelat ndërtimore, sipas Planit Rregullues H-5-5 dhe H-5-6, ndërsa parcelat ndërtimore H-5-7 dhe H-5-8, ku shtrihen pjesërisht parcelat tuaja nuk janë trajtuar me “Kushtet ndërtimore” të lartë cekura.